



**Republika e Kosovës
Komuna e Kaçanikut**

Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

01.Nr. zyrtar/ 2021

Procesverbal

Takimi i V-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021

Më 28.09.2021

Në takim prezantuan:

Ylber Bajra, Nëkryetar i Komunës

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Përfaqësuesi i FSK

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Remzi Reka, OMM,,Gjethi”

Jashar Selimi, Këshilli i Prindërve

Fidaim Fazliu, Bashkësia Islame

Lirije Luta, Komiteti për Komunitete

Fadil Guri, Zyra për Komunitete dhe Kthim

Me arsyetim mungoi: Zahir Doda, Ramadush Osmani dhe Vedat Dema.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës së Kaçanikut **z.Ylber Bajra** i cili prezantoi pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut,
3. Trajtimi i ankesave të qytetarëve për sigurinë
4. Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të Punës për vitin 2022
5. Të ndryshme.

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Procesverbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës Komandanti i stacionit të policisë në Kaçanik **z.Halim Shehu** tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile. Kemi pasur një rast të vjedhjes së derivateve të naftës në një eskavatorë dhe një problematikë e kahmotshme e prerjes ilegale të pyjeve , ku falë angazhimit të stafit policorë , bashkëpunimit me rojet e pyllit dhe komunës , kemi arritur që këtë dukuri ta pengojmë në masë të madhe . Rënduese është gjendja e Parkut Nacional i cili është dëmtuar në masë të madhe dhe për këtë problematikë kemi pasur një takim të përbashkët me Ministrin i cili u zotua se do të angazhohen edhe më shumë në parandalimin e kësaj dukurie . Fushatat zgjedhore janë duke shkuar mirë dhe partitë politike janë duke ju përmbajtur masave të pandemisë. Në këto fushata i kemi të angazhuar dy zyrtarë policorë të cilët monitorojnë këtë aktivitet politik. Sa i përket gjendjes së komunikacionit mundë të them se gjendja është e mirë. Ka pasur persona të pandërgjegjshëm që dalin në trafik pa regjistrim por që ne kryejmë punën tonë duke lëshuar edhe xhoba.

Nënkryetari:Ju përgëzoj për punën që jeni duke e bërë dhe bashkëpunimi nuk do të mungoj çdo herë që ju e kërkon.

Sh.Abazi:Për shkak të orës policore ne stafi i klubit futbollistik „Lepenci”nuk po mundemi që të i bëjmë vizitë stadionit të qytetit dhe kërkoj mirëkuptimin e juaj për këtë qështje.

K.i Policisë: Kohën e lëvizjes e përcakton niveli qendrorë dhe dihet se kush mundë të lëvizë pas orës 22:00 . Për këtë qështje që ju po e paraqitni mundë të bëni kërkesë e cila edhe shqyrtohet .

R.Reka: edhe unë përgëzoj komandantin dhe stafin e tij për punën që kanë bërë në lidhje me ruajtjen e pyjeve por që kam disa kërkesa :

- Të lirohen trotuaret nga veturat sidomos të shkollës fillore „Emin Duraku”dhe për rreth rrugës që të qon në shkollën e Mesme Profesionale.

- Të mos lëshohen leje për punë të bizneseve që nuk i plotësojnë kriteret , e këtu e kam fjalën për marketin Interex që është mirë që ka punësuar disa të papunë por që nuk ka hapsirë të mjaftueshme për parkingje ku si pasojë e kësaj po bllokohen trotuaret .

- Kërkesën e fundit e kam në lidhje me situatën pandemike , ku tashmë është mbyllë qendra e testimeve dhe ka persona që shkojnë në shtëpinë e shëndetit , nuk regjistrohen dhe as nuk udhëzohen se ku të shkojnë dhe sipas mendimit tim kjo paraqet një brengë.

K.i Policisë:lirimi i trotuareve është një brengë që na ka përcjellë me vite.Në rrugë „Qamil Ilazi”problemi është i qështjes pronsore dhe me këtë problematikë duhet të mirret komuna , ndërsa në rrugën „Vëllezërit Çaka”së bashku me inspektorët komunal u kemi dhënë disa herë vërejtje por edhe kemi lëshuar xhoba .Inspektorët kërkojnë asistencën tonë në kryerjen e punës së tyre dhe ne jemi të gatshëm që çdo herë të e ofrojmë këtë asistencë.

R.Reka: Situata nuk është e mirë në lidhje me trotuaret dhe kërkoj që mos të keni mëshirë për ata që pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve .

Nënkryetari: në krahasim me të kaluarën mundë të them se situata ka ndryshuar në të mirë por që duhet bashkëpunuar për të pasur një gjendje edhe më të mirë.

F.Guri :Unë personalisht nuk jam që të i denojmë qytetarët që nganjëherë edhe e pengojnë lëvizjen e lirë . Ata vet do të vetdijësohen në të ardhmën që të krijojnë hapsira nga prona e tyre ngase krijimi i hapsirave është edhe në të mirë të tyre .

F.Fazliu: Shfrytëzoj rastin të falënderoj komunën dhe komandantin e policisë për bashkëpunimin shumë të mirë që kanë me Bashkësinë Islame. Falë këtij bashkëpunimi në këtë periudhë kohore gjendja e sigurisë nëpër objekte fetare ka qenë e qetë. Dua me u ndërlidhë me pengesat mbi trotuare e ku po e potencoj rrugën Bajnicë-Duraj ku shtyllat elektrike kanë mbetur në mes të rrugës . Gjithashtu po më intereson situata me pandeminë nëpër shkolla , a janë marrë të gjitha masat për me pasë një situatë normale në ambientet shkollore .

Sa i përket çështjes së ruajtjes së pyjeve , unë respektoj punën që ka bërë policia por që mendoj se nuk është ashtu siç po raportohet ngase ky aktivitet ilegal është duke vazhduar ende . Gjithashtu edhe dukuria e vjedhjes është ende e pranishme dhe duhet që të punojmë në këtë drejtim për mos përhapjen e sajë .

Nënkryetari: Sa i përket shtyllave elektrike në rrugë e trotuare unë mendoj se është një neglizhencë e kompanisë KEDC e cila nuk po e kryen punën e sajë edhe pse ne si institucion kemi bërë kërkesa të shumta në ofrim të shërbimeve .

F.Qaka:Gjatë një aktiviteti që kemi bërë me të rinjë në fshatin Shtrazë , kemi vërejtur që kjo pjesë aq sa është atraktive për vizitorë , është bërë edhe një rrezik ngase aty ka edhe persona të pandërgjegjshëm që prishin imazhin e kësaj pjese duke shkaktuar zhurmë me mjete motorristike, vozitje e shpejtë, shkatërrim të ambientit dhe dukuri tjera të pa hijshme. Kemi parë edhe fëmijë duke vozitur , automjete pa regjistrim por edhe ndotje të natyrës nga mbeturinat e hedhura.

K.i Policisë: Është punuar shumë në zbulimin e rasteve të vjedhjeve dhe besoj se ka rënë shumë kjo dukuri .Nga momenti që është kapur një strukturë e organizuar që është marrë me këtë dukuri mundë të them se gjendja është shumë më e mirë sa i përket kësaj çështje.

3. Trajtimi i ankesave të qytetarëve për sigurinë

Nënkryetari: Në bazë të informatave që kemi nga komisioni për hapjen e kutive të ankesave të qytetarëve që lidhen me sigurinë publike , nuk kemi asnjë ankesë nëpër kuti që janë të vendosura nëpër institucione.Ankesat qytetarët i kanë bërë duke u drejtuar zyrës së Kryetarit dhe drejtorive në formë fizike . Ankesa me shkrim edhe ka pasur por që nuk kishin të bëjnë me sigurinë publike .

4. Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të Punës për vitin 2022

Nënkryetari: Propozoj që në këtë grup punues për hartimin e Planit të Punës së KKSB për vitin 2022 të jenë:

-Zahir Doda

-Remzi Reka

-Jashar Selimi

Me këtë propozim u pajtuan të gjithë të pranishmit dhe në takimin e radhës ky plan do të prezantohet nga ky grup dhe më pas do të përcillet në Kuvend Komunal për miratim

5.Të ndryshme

Gzim Morina: Ne si FSK në këtë kohë jemi marrë me shpërndarje të maskave nëpër institucione publike, OJQ dhe nëpër rrugë. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë në çdo iniciativë që ndërmerret në të mirë të komunitetit .

F.Guri: Propozoj që takimet e KKSb-së të mbahen nga ora 10:00, ngase shumica nga ne jemi të angazhuar edhe me punë të tjera dhe po e humbim pushimin e drekës.

REKOMANDIMET:

1.Të bëhet liri i trotuareve nga automjetet sidomos në rrugën „Qamil Ilazi” dhe „Vëllezërit Çaka”

2.Të mos lëshohen leje për biznese nëse nuk i plotësojnë kriteret për të zhvilluar aktivitet biznesore

3.Të regjistrohen dhe të këshillohen personat të cilët kërkojnë të ju bëhet testi i COVID-19 , ku për fat të keq qendra e testeve është mbyllur.

4.Institucionet komunale të mirren seriozisht me çështjet e pronave private që janë në trotuare.

5.Të bëhet zhvendosja e shtyllave elektrike që gjinden nëpër rrugë e trotuare.

Pas këtyre diskutimeve Nënkyetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kryesuesi: Nënkyetari i Komunës
z. Ylber Bajra



Procesmbajtës:
Fatmir Qaka